



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE MJEDISIT
KOMISIONI I ZGJEDHJEVE TË FAKULTETIT TË BUJQËSISË DHE MJEDISIT

Njoftim

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët që kandidojnë për anëtarë të komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, UBT

Bazuar në Rregulloren e Zgjedhjeve të Universitetit Bujqësor të Tiranës, neni 25, dokumentat që duhet të dorëzojnë kandidatët që kandidojnë për anëtarë të komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në FBM, UBT, janë si më poshtë:

- a) Kërkesa për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Dëshmia e penalitetit;
- c) Deklarimi se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- d) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- e) Kopje të noterizuar të titullit akademik;
- f) Vërtetimin e verifikimit të ligjshmërisë së dosjes të promovimit akademik dhe vlerësimin antiplagjaturë për kandidatët për anëtarë të komisioneve të përhershme.
- g) Dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar.

Dokumentat do të dorëzohen pranë Godinës së Agronomisë, Kati i parë, Salla 101, duke filluar nga data 13.10.2025-17.10.2025, ora 8:00-16:00.

Kryetari i Komisionit të Zgjedhjeve të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit

Dr. Jolia Korita